TFL
TOGETHER FOR LIFE



Ndikimi i COVID-19 tek personat me aftësi të kufizuar

WFD

Funded by UK Government

TFL
TOGETHER FOR LIFE

Ndikimi i COVID-19 tek personat me aftësi të kufizuar

WFD
WESTMINSTER FOUNDATION FOR DEMOCRACY

Funded by UK Government

Raporti u përgatit nga:
Alma Lahe
Arlinda Shehu

Udhëheqëse e grupit të punës studimore:
Denisa Celami (Canameti)

Redaktoi:
Blertina Koka

Autorët e prodhuan këtë raport për Fondacionin Westminster për Demokraci. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë ato të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose Fondacionit Westminster për Demokraci.



QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport synon të vlerësojë nivelin e aksesit të Personave me Aftësi të Kufizuara në shërbime dhe institucione gjatë situatës pandemike, si dhe të analizojë nevojat e tyre ekonomike dhe financiare për të përballuar pasojat e krizës së shkaktuar nga COVID-19.

AKRONIME

PAK	Persona me aftësi të kufizuar
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
COVID-19	COVID - 19 është sëmundje e shkaktuar nga SARS - CoV-2, virus nga familja koronavirus, fillimisht zbuluar në Kinë në dhjetor të vitit 2019.
TFL	Shoqata “Together for Life”
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik

HYRJE

COVID-19 ka vënë në vështirësi njerëzit në të gjithë botën, duke rritur vështirësitë e grupeve të cenueshme, veçanërisht të Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK). Sfidat e personave me aftësi të kufizuar dhe të familjeve të tyre po thellohen akoma më shumë nga COVID-19, dhe ata, së bashku me familjet e tyre, do të jenë ndër më të prekurit nga kjo krizë shëndetësore dhe ndikimet e saj shkatërruese sociale dhe ekonomike.

Sa i takon të dhënave statistikore, në të gjithë vendin rezulton se 6,2% e shqiptarëve kanë një aftësi të kufizuar. Të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tregojnë se numri total i personave me aftësi të kufizuar është 74.194.

Numri i kujdestarëve është 19,874. Gjithashtu, nga skema e mbrojtjes sociale përfitojnë pagesa 74,350 invalidë të punës.

"*Shumë pak është bërë për t'u siguruar njerëzve me aftësi të kufizuara udhëzimet dhe mbështetjen e nevojshme për t'i mbrojtur ata gjatë pandemisë në vazhdim COVID-19, edhe pse shumë prej tyre janë pjesë e grupit me rrezikshmëri të lartë*", paralajmëroi më 17 mars raportuesja speciale e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Catalina Devandas.[1]

Mediat gjithashtu kanë raportuar[2] për mungesë aksesi në shërbime shëndetësore, vështirësi financiare dhe problematika të tjera komplekse me të cilat janë përballur personat me aftësi të kufizuara, duke pretenduar se ata nuk kanë qenë pjesë e aksioneve/vendimeve që u ndërmorën për të ndihmuar target grupet e veçanta në përballimin e COVID-19.

OBJEKTIVAT E SONDAZHIT

Ky sondazh ka si qëllim që të ofrojë një analizë të situatës ekonomike dhe shëndetësore të personave me aftësi të kufizuar gjatë periudhës së COVID-19. Kjo analizë mund të shërbejë si bazë për veprimet që Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale do të ndërmarrë për mbështetjen e kësaj kategorie në vazhdim të përpjekjeve për menaxhimin e situatës së krijuar nga koronavirusi i ri.

1. https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-411/
2. https://citizens-channel.com/2020/05/19/personat-me-aftesi-te-kufizuar-te-harruar-edhe-pergjate-fazes-se-2-te-te-pandemise-covid-19/
https://portavendore.al/2020/04/09/jeta-e-veshtire-e-personave-me-aftesi-te-kufizuar-ne-karantine/
https://abcnews.al/personat-me-aftesi-te-kufizuar-te-harruar-nga-shteti-murataj-shume-prej-tyre-jetojne-vetem/

Funded by UK Government

VENDNDODHJA / MBULIMI

Sondazhi u krye në 6 qarqe të vendit:

- Durrës
- Elbasan
- Gjirokastër
- Korçë
- Shkodër
- Tiranë

METODOLOGJIA

Sondazhi u zhvillua në formën e një ankete sasiore në terren. Në anketë morën pjesë 360 individë: 199 ose 55.3% e pjesëmarrësve ishin persona me aftësi të kufizuar (PAK), kurse pjesa tjetër, 161 persona ose 44.7% e të anketuarve, ishin kujdestarë ose prind të një personi me aftësi të kufizuar.
Metodologjia e përdorur na jep mundësinë të kemi një kuptueshmëri të gjendjes aktuale, në aspektin e arsyetimeve, perceptimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të PAK, si aktorë kryesorë dhe, në të njëjtën kohë, sasinë/volumin e këtyre rezultateve. Pyetësori u hartua duke synuar mbledhjen e informacioneve mbi perceptimet, qëndrimet, sjelljet dhe përvojat e PAK gjatë periudhës së COVID-19.
Pyetësori përmban:

- Pyetje filtruese për moshën, gjininë
- Situatën ekonomike gjatë periudhës së COVID-19
- Situatën shëndetësore
- Testimi COVID-19

DETAJET TEKNIKE TË HULUMTIMIT SASIOR

"Together for Life" bashkëpunoi me shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Qarqet e zgjedhura për realizimin e këtij pyetësori. Personat e përzgjedhur nga vetë shoqatat për t'u angazhuar ishin me përvojë për të kryer intervistat.
Kohëzgjatja mesatare e një interviste ishte 15 minuta.
Të gjithë të anketuarve iu bë e ditur se përgjigjet e tyre do të mbeteshin plotësisht anonime dhe të fshehta, duke u përpunuar statistikisht.
Pas kontrollit fizik të pyetësorëve, hedhja e të dhënave u realizua nga operatorë me përvojë, duke përdorur një program të veçantë (SPSS).



REZULTATET

1.1. Të dhëna të përgjithshme për pjesëmarrësit në hulumtim

Në hulumtim morën pjesë 360 individë: 199 ose 55.3% e pjesëmarrësve ishin persona me aftësi të kufizuar (PAK), kurse pjesa tjetër, 161 persona ose 44.7% e pjesëmarrësve në studim, ishin kujdestarë ose prind të një personi me aftësi të kufizuar (Tabela 1).

Tabela 1. Roli i pjesëmarrësve në studim

Variabli	Numri absolut	Përqindja
Roli në studim		
Unë jam person me aftësi të kufizuar	199 *	55.3
Unë jam prind / kujdestar i një personi me aftësi të kufizuar	161	44.7


*Çdo mospërputhje me numrin total vjen si pasojë e mungesës së informacionit.

Të dhënat bazë socio-demografike të personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrës në studim paraqiten në Tabelën 2. Rreth 24% e PAK ishin 18 vjeç ose më të rinj në momentin e studimit, rreth 40% ishin 18-30 vjeç, kurse pjesa tjetër ishte mbi 30 vjeç. Rreth 51% e PAK ishin meshkuj dhe rreth tre të katërtat (76%) jetonin në zonat urbane. Po kështu, 32.2% e PAK të intervistuar banonin në Qarkun e Tiranës, 11.9% në qarkun e Durrësit, 13.9% në qarkun e Shkodrës, 12.5% në qarkun e Elbasanit, 13.6% në qarkun e Korçës dhe 15.8% në qarkun e Gjirokastrës. (Tabela 2 dhe Grafiku 1).

Tabela 2. Karakteristikat bazë të personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrës në studim

Variabli	Numri absolut	Përqindja
Mosha		
5-10 vjeç	29 *	8.1
11-18 vjeç	55	15.3
19-30 vjeç	58	16.2
31-40 vjeç	64	17.8
41-50 vjeç	62	17.3
51-60 vjeç	54	15.0
>60 vjeç	37	10.3
Gjinia		
Mashkull	184	51.4
Femër	174	48.6
Vendbanimi		
Qytet	267	75.9
Fshat	85	24.1
Qarku		
Tirana	116	32.2
Durrës	43	11.9
Shkodër	50	13.9
Elbasan	45	12.5
Korçë	49	13.6
Gjirokastër	57	15.8

*Çdo mospërputhje me numrin total vjen si pasojë e mungesës së informacionit.




Grafiku 1. Karakteristikat bazë të pjesëmarrësve në studim

Funded by UK Government

1.2.Të dhëna lidhur me aftësinë e kufizuar


1.2.1. Lloji i aftësisë së kufizuar dhe numri i tyre

Pjesëmarrësit u pyetën lidhur me llojin e aftësisë së kufizuar. Këto të dhëna paraqiten në Grafikun 2. Lloji më i shpeshtë i paaftësisë ishte ajo që kishte të bënte me të ecurit dhe ngjitjen e shkallëve (44.2%), pasuar me kujdesin e përditshëm për veten (30.3%), probleme me kujtesën/përqendrimin (18.6%), probleme të komunikimit (18.6%), probleme të shikimit (10.3%), probleme të dëgjimit (6.7%) dhe Sindroma Down (0.3%).




Grafiku 2. Prevalenca e llojeve të ndryshme të paaftësive

Lidhur me numrin e paaftësive, mbi tre të katërtat e personave me aftësi të kufizuara (78.6%) kishin një lloj paaftësie, 14.7% kishin dy paaftësi, 5.8% kishin tri lloje aftësish të kufizuara dhe 0.8% kishin katër lloje aftësish të kufizuara (Grafiku 3).



Grafiku 3. Numri i aftësive të kufizuara midis pjesëmarrësve

Rreth një e katërta e PAK (23.8%) deklaruan se përjetojnë një farë vështirësie për të kryer detyrat e përditshme për shkak së aftësisë së tyre të kufizuar, 51.9% deklaruan shumë vështirësi kurse 24.3% e kishin fare të pamundur për të kryer detyrat e përditshme për shkak të paaftësisë së tyre (Grafiku 4).




Grafiku 4. Shkalla e vështirësisë për të kryer detyrat e përditshme për shkak të aftësisë së kufizuar

1.3.Situata ekonomike gjatë periudhës së pandemisë COVID-19

1.3.1. Statusi i punësimit para pandemisë COVID-19

Pjesëmarrësit u pyetën lidhur me statusin e punësimit të personave me aftësi të kufizuar përpara pandemisë COVID-19. Këto të dhëna paraqiten në Grafikun 5. Më shumë se 4 në 10 persona me aftësi të kufizuar rezultuan se ishin të papunë përpara pandemisë, 27.9% ishin në shkollë, 14.2% në pension, 2.4% invalid dhe vetëm 11.8% ishin të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme (Grafiku 5).




Grafiku 5. Statusi i punësimit para pandemisë COVID-19

Midis personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 18 vjeç (në moshë pune) të cilët dhanë informacion për statusin e punësimit (n=258), duke përjashtuar ata që deklaruan se janë në shkollë (n=17), pension (n=48) dhe invalidët, n=48), vetëm 21.5% e tyre (40 individë ose 40/186) ishin të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme (kjo e dhënë nuk paraqitet në grafikë). Midis personave me aftësi të kufizuar në marrëdhënie pune para pandemisë COVID-19, 50% e tyre ishin të pasiguruar, pra punonin në mënyrë informale, dhe pjesa tjetër prej 50% ishin të siguruar (këto të dhëna nuk paraqiten në grafikë). Ndërkohë, rreth dy të tretat (62.5%) e personave me aftësi të kufizuar që ishin në marrëdhënie pune

Funded by UK Government


para pandemisë deklaruan se e humbën punën (22.5%) ose u pezulluan nga puna (40%) gjatë kohës së pandemisë COVID-19, ndërsa për 37.5% të tyre marrëdhëniet e punës nuk ndryshuan (Grafiku 6).



Grafiku 6. Ndryshimi i statusit të punësimit gjatë pandemisë COVID-19 midis personave me aftësi të kufizuar


Grafiku 7 paraqet ndryshimin e statusit të punësimit për personat me AK gjatë pandemisë COVID-19, sipas karakteristikave të tyre.

Mund të vihet re që përqindjet e PAK që humbën punën gjatë pandemisë janë më të larta midis femrave sesa meshkujve (33.3% vs. 11.1%, përkatësisht), rritet me rritjen e moshës (36.4% e atyre 41.50 vjeç dhe 50% e atyre 51-60 vjeç dhe >60 vjeç, secili), midis PAK që jetojnë në fshat sesa në qytet (33.3% vs. 20.6%, përkatësisht), midis PAK që jetojnë në Durrës (66.7%) dhe Korçë (40%), dhe midis PAK me dy paaftësi, 100% e të cilëve humbën punën gjatë pandemisë krahasuar me 21.6% të PAK me një aftësi (Grafiku 7).



Grafiku 7. Ndryshimi i statusit të punësimit gjatë pandemisë COVID-19 midis PAK, sipas faktorëve të pavarur


Midis PAK të cilët vazhduan të ishin në marrëdhënie pune gjatë pandemisë COVID-19 (n=15), në 73.3% të rasteve paga e tyre nuk ndryshoi, në 20% të rasteve paga pësoi ulje me 30% dhe në 6.7% të rasteve paga u ul me 50% (Grafiku 8).



Grafiku 8. Ndryshimi i pagës midis PAK që e ruajtën vendin e punës gjatë pandemisë COVID-19 (n=15)


1.3.2. Probleme financiare si rezultat i drejtpërdrejtë i pandemisë COVID-19

Pjesëmarrësit u pyetën nëse kishin përjetuar probleme financiare si pasojë e drejtpërdrejtë E pandemisë COVID-19. Më shumë se 8 në 10 persona (83.6%) me aftësi të kufizuar të cilët dhanë informacion (n=336) kanë përjetuar probleme financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pandemia COVID-19 (Grafiku 9).



Grafiku 9. Probleme financiare si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë


Grafiku 10 paraqet përqindjet e personave me aftësi të kufizuar që kanë përjetuar probleme financiare si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë COVID-19, sipas faktorëve të pavarur në studim. Përqindjet më të larta janë midis personave me aftësi të kufizuar të moshës 51-60 vjeç (94.2%), midis meshkujve (85.5%), midis atyre që banojnë në zonat rurale (91.1%) dhe në Durrës (97.6%) e Shkodër (90%), si dhe midis personave me 4 lloje të ndryshme paaftësish, 100% e të cilëve u shprehën se kanë përjetuar probleme financiare si pasojë drejtpërdrejtë e pandemisë (Grafiku 10).



Grafiku 10. Përqindja e PAK që kanë përjetuar probleme financiare nga pandemia COVID-19, sipas faktorëve të pavarur

Ata që deklaruan se kishin përjetuar probleme financiare si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë COVID-19 u ftuan të specifikonin llojin e problemeve financiare të përjetuara. Përgjigjet e tyre paraqiten në Grafikun 11.


Pjesa dërrmuese e personave me aftësi të kufizuar ose kujdestarëve të tyre që kishin probleme financiare për shkak të pandemisë, raportuan se problemi financiar kryesor i drejtpërdrejtë i pandemisë COVID-19 ishte "të ardhurat e pakta dhe pamundësia për të përballuar jetesën, ushqimin dhe ilaçet", e përmendur nga 79.8% e pjesëmarrësve, pasuar nga 10.1% që deklaruan se ata vetë ose familjarët e tyre kishin humbur vendin e punës, 4% u ankuan për shpenzimet shtesë për ushqime, ilaçe dhe detergjente, 1.6% raportuan vonesa në hedhjen e rrogës dhe po kaq raportuan ulje të të ardhurave dhe reduktim të pagës, etj.



Grafiku 11. Llojet e problemeve financiare si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë

1.3.3. Mbështetja financiare gjatë pandemisë COVID-19

Shumica dërrmuese e individëve me aftësi të kufizuar (90.8%) deklaruan se nuk kishin përfituar asgjë nga paketa financiare e qeverisë, 5% kanë përfituar nga paketa e parë dhe 4.2% nga paketa e dytë (Grafiku 12). Ky grafik përfshin të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pavarësisht statusit të punësimit (para dhe gjatë pandemisë) nëse kanë përfituar nga ndihmat që qeveria ka dhënë në kuadër të përballimit të COVID-19 (nuk i referohet pagesave mujore që PAK i kanë marrë sipas afateve dhe ligjit).




Grafiku 12. Përqindja e PAK që kanë përfituar nga paketat financiare të qeverisë

Funded by UK Government

Përveç ndihmës nga paketat financiare të qeverisë, pjesëmarrësit u pyetën nëse kanë marrë ndihma në ushqime, para ose në formën e shërbimeve gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 dhe në rast se po, cilat ishin burimet e kësaj mbështetje. Këto të dhëna paraqiten në Grafikun 13. Mund të vihet re që afërsisht katër në dhjetë persona me aftësi të kufizuar (40.6%) kanë marrë mbështetje nga organizata apo fondacione të ndryshme gjatë pandemisë COVID-19, një në katër persona me aftësi të kufizuar (25%) kanë marrë mbështetje në shërbime apo ushqime nga institucionet publike si Bashkia apo institucionet e tjera të përkujdesjes dhe 21.4% janë mbështetur nga të afërmit apo familjarët e tyre.

Ndërkohë, më shumë se një në pesë persona me aftësi të kufizuar (21.7%) nuk kanë marrë asnjë ndihmë gjatë periudhës së pandemisë (nuk kanë përfituar as nga paketat financiare të qeverisë dhe as nga burime të tjera si të afërmit, institucionet e tjera publike apo organizatat/fondacionet), 70.3% kanë marrë mbështetje nga një burim, 7.5% nga dy burime dhe 0.6% nga tre burime (Grafiku 13). Ky grafik i referohet ndihmave shtesë që qeveria apo organizmat e tjerë kanë dhënë në kuadër të menaxhimit të COVID-19, përveç pagesës së përmuajshme të cilën e kanë marrë sipas ligjit.




Grafiku 13. Përqindja e PAK që kanë përfituar ndihma nga burime të ndryshme gjatë pandemisë COVID-19

Në Grafikun 14 paraqiten përqindjet e pjesëmarrësve me aftësi të kufizuar të cilët nuk përfituan mbështetje nga asnjë burim gjatë kohës së pandemisë COVID-19, sipas faktorëve të pavarur të përfshirë në sondazh.

Vihet re qe me rritjen e moshës rritet përqindja e personave me aftësi të kufizuar që nuk kanë marrë asnjë mbështetje nga asnjë burim gjatë pandemisë: nga 21% midis PAK me moshë 41-50 vjeç, në 25.9% tek ata me moshë 51-60 vjeç dhe 29.7% tek PAK mbi 60 vjeç.

Po kështu, përqindjet e PAK që nuk kanë marrë asnjë mbështetje gjatë pandemisë janë më të larta midis meshkujve, midis atyre që jetojnë në zonat urbane, midis PAK që banojnë në Durrës (34.9%), Elbasan (31.1%) dhe Gjirokastër (29.8%). Po kështu, ka një tendencë që përqindja e PAK që nuk ka marrë asnjë mbështetje të rritet me rritjen e numrit të paaftësive

duke kaluar në 28.6% tek PAK me tre paaftësi dhe 33.3% tek ata me katër paaftësi të ndryshme (Grafiku 14).




Grafiku 14. Përqindja e PAK që nuk kanë përfituar ndihma nga burime të ndryshme gjatë pandemisë COVID-19, sipas faktorëve të pavarur

Funded by UK Government

Lidhur me vonesat në marrjen e pagesës së përmuajshme të paaftësisë, 39.3% e personave me PAK kanë përjetuar vonesa të tilla gjatë periudhës së pandemisë.

Midis atyre që kanë përjetuar këto vonesa, 42.3% u shprehën se kjo ka ardhur për shkak të akordimit me vonesë të fondeve nga buxheti i shtetit, 57.7% deklaruan se kishte vështirësi për t'i tërhequr pagesat për shkak të izolimit dhe 11.7% ishin të pamundur fizikisht për t'i tërhequr në kohë fondet. Në total, 90.5% e PAK raportuan një arsye për vonesat në marrjen e pagesës së paaftësisë, 7.3% raportuan dy arsye vonese dhe 2.2% raportuan tri arsye (Grafiku 15).




Grafiku 15. Përqindja e PAK që kanë përjetuar vonesa në marrjen e pagesës së paaftësisë sipas arsyeve të vonesës dhe numrit të tyre

1.4. Situata shëndetësore e PAK gjatë periudhës së pandemisë COVID-19

1.4.1. Vendi i trajtimit të aftësisë së kufizuar para dhe pas pandemisë COVID-19

Pjesëmarrësit u pyetën lidhur me vendin ku e trajtonin paaftësinë e tyre, para dhe pas pandemisë COVID-19. Këto të dhëna paraqiten në Grafikun 16.



Grafiku 16. Vendi i trajtimit të aftësisë së kufizuar, para dhe pas pandemisë COVID-19


Mund të vihet re se ka dallime të mëdha para dhe pas pandemisë lidhur me këtë tregues. Kështu, para pandemisë 6.1% e PAK trajtoheshin në një qendër rezidenciale, po kjo përqindje ulet në 0.6% pas pandemisë; para pandemisë 9.7% e PAK trajtoheshin në një qendër ditore vs. 0.6% pas pandemisë; para pandemisë 6.4% e PAK trajtoheshin në një qendër komunitare vs. 0.3% pas pandemisë. Pas pandemisë u rrit dukshëm përqindja e PAK që e trajtonin në shtëpi paaftësinë e tyre (60.3% vs. 45.8% para pandemisë). Po kështu, 31.9% e PAK e trajtonin paaftësinë e tyre në vende të tjera veç këtyre të përmendura (si spital, klinikë, kishë, apo vende të tjera) krahasuar me 23.3% që bënin diçka të tillë pas pandemisë. Këto ndryshime rezultuan shumë domethënëse nga ana statistikore (vlera e p-së sipas testit McNemar për dy mostra të lidhura <0.001).

Për t'u shënuar është edhe fakti që 15% e personave me aftësi të kufizuar e ndërprenë trajtimin e aftësisë së kufizuar të tyre pas pandemisë (Grafiku 16).

Funded by UK Government

1.4.2. Koha e izolimit si pasojë e pandemisë COVID-19


Pjesëmarrësit u pyetën lidhur me kohën që qëndruan të izoluar si pasojë e pandemisë COVID-19. Rreth 70% e personave me aftësi të kufizuar qëndruan të izoluar për tre muaj, rreth 3% u izoluan për një muaj, 12% u izoluan për dy muaj, rreth 15% deklaruan se vazhdojnë të jenë të izoluar, kurse rreth 4% raportuan se nuk u izoluan (Grafiku 17).



Grafiku 17. Koha e qëndrimit të izoluar të PAK si pasojë e pandemisë Covid-19


1.4.3. Gjendja shëndetësore e PAK gjatë periudhës së izolimit

Gjatë periudhës së izolimit ose kufizimit të lëvizjes si pasojë e pandemisë COVID-19, gjendja shëndetësore u përkeqësua për rreth 37% të personave me aftësi të kufizuar, ndërkohë që nuk ndryshoi për 63% të tyre dhe u përmirësua në 0.6% të rasteve (Grafiku 18).



Grafiku 18. Gjendja shëndetësore e PAK gjatë periudhës së izolimit

Grafiku 19 paraqet përqindjet e individëve me aftësi të kufizuar gjendja shëndetësore e të cilëve u përkeqësua gjatë periudhës së izolimit, sipas faktorëve të pavarur në studim.
Në përgjithësi, nuk ka ndonjë trend të qartë linear të përqindjes së PAK shëndeti i të cilëve u përkeqësua gjatë izolimit sipas faktorëve të pavarur. Kjo përqindje u paraqit më e lartë tek PAK me moshë 11-18 vjeç (53.7%) dhe tek ata 51-60 vjeç (53.1%), tek PAK që jetojnë në zonat rurale (45.9%) apo në Durrës (46.3%) dhe Korçë (42.6%), dhe tek personat me dy (51.9%) dhe tri lloje të ndryshme paaftësish (50%).




Grafiku 19. Gjendja shëndetësore e PAK gjatë periudhës së izolimit, sipas faktorëve të pavarur

Funded by UK Government


1.4.4. Ndihma shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19

Më shumë se gjysma e personave me aftësi të kufizuar (56.4%), për të cilët ka informacion, kanë kërkuar ndihmë shëndetësore gjatë periudhës së pandemisë. Midis këtyre, 65.1% kanë kërkuar ndihmë tek mjeku i familjes, 26.5% tek mjeku specialist, 3.2% kanë kërkuar ndihmë edhe tek mjeku i familjes edhe tek mjeku specialist dhe 5.3% kanë kërkuar ndihmë në burime të tjera, të tilla si: familjarët, miqtë, mjeku psikiatër, shoqata të ndryshme, spital, etj. (Grafiku 20).




Grafiku 20. Burimi ku PAK kanë kërkuar ndihmë shëndetësore gjatë pandemisë

Pjesëmarrësit që deklaruan se kanë përdorur sistemin shëndetësor gjatë pandemisë (të tria nivelet) u ftuan të vlerësonin shërbimin e marrë në këto institucione gjatë pandemisë. Përgjigjet e tyre paraqiten në Grafikun 21. Sipas pjesëmarrësve, shërbimi shëndetësor gjatë pandemisë u përkeqësua në 17.3% të rasteve, u përmirësua në 8.4% të rasteve dhe nuk ndryshoi në pjesën dërrmuese (74.3%) të rasteve.



Grafiku 21. Vlerësimi i shërbimit shëndetësor gjatë pandemisë

Grafiku 22 detajon përqindjet e PAK që mendojnë se shërbimi shëndetësor gjatë pandemisë është përkeqësuar sipas faktorëve të pavarur në studim.



Grafiku 22. Përqindja e PAK që mendon se shërbimi shëndetësor është përkeqësuar gjatë pandemisë, sipas faktorëve të pavarur

Me përjashtim të moshës, të gjitha diferencat e tjera janë domethënëse nga ana statistikore ($p<0.05$). Kështu, përqindjet e PAK që mendojnë se shërbimi shëndetësor gjatë pandemisë është përkeqësuar është në mënyrë domethënëse më i lartë midis meshkujve, atyre me banim në zonat rurale, Shkodër, Korçë dhe Elbasan dhe rritet me rritjen e numrit të paaftësive. Lidhja me numrin e paaftësive është shumë domethënëse statistikisht, është pozitive dhe ka trend linear; domethënë, me rritjen e numrit të paaftësive, rritet në mënyrë domethënëse përqindja e PAK që mendojnë se shërbimi shëndetësor gjatë pandemisë është përkeqësuar: 10.4% midis PAK me një lloj paaftësie, 34.4% midis PAK me dy lloje paaftësish, 45.5% midis PAK me tri lloje paaftësish dhe 100% midis PAK me katër lloje paaftësish (Grafiku 22).

Funded by UK Government

Për sa i përket shpeshtësisë së kontaktimit të mjekut të familjes gjatë pandemisë, 23.9% e PAK të cilët dhanë informacion deklaruan se kanë kontaktuar më shumë se zakonisht, 48.7% kanë kontaktuar si zakonisht dhe 27.5% kanë kontaktuar më pak se zakonisht (Grafiku 23).




Grafiku 23. Shpeshtësia e kontaktit me mjekun e familjes gjatë pandemisë COVID-19

Përqindja e PAK që kanë kontaktuar më pak se zakonisht me mjekun e familjes rezultoi në mënyrë domethënëse më e lartë midis PAK që jetojnë në Shkodër (60%) dhe Elbasan (31%), ndërkohë që diferencat e tjera nuk rezultuan statistikisht domethënëse (këto të dhëna nuk paraqiten në Grafikë).

1.4.5. Aksesi në medikamente para dhe gjatë pandemisë COVID-19


Pjesëmarrësit u pyetën rreth shkallës së vështirësisë lidhur me aksesin ndaj medikamenteve në periudhën para dhe gjatë pandemisë COVID-19. Përgjigjet e tyre paraqiten në Grafikun 24. Mund të vihet re që gjatë pandemisë është rritur në mënyrë domethënëse përqindja e PAK që deklarojnë se kanë pasur shumë vështirësi për aksesin në medikamente gjatë pandemisë, krahasuar me periudhën para pandemisë (40.7% vs. 9%, përkatësisht), kjo kryesisht në sajë të uljes së përqindjes së PAK të cilët nuk e kanë pasur aspak të vështirë, e kanë pasur jo të vështirë ose mesatarisht të vështirë aksesin ndaj medikamenteve gjatë pandemisë, krahasuar me periudhën para pandemisë. Këto ndryshime janë shumë domethënëse nga ana statistikore ($p<0.001$ sipas testit McNemar për dy mostra të lidhura).



Grafiku 24. Shkalla e vështirësisë në aksesin ndaj medikamenteve para dhe gjatë pandemisë

Funded by UK Government

Grafiku 25 paraqet përqindjen e PAK që kanë pasur vështirësi ose shumë vështirësi në aksesin ndaj medikamenteve para dhe gjatë pandemisë, sipas faktorëve të pavarur në studim.
Mund të vihet re që përqindja e PAK që kanë pasur vështirësi ose shumë vështirësi për aksesin ndaj medikamenteve gjatë pandemisë COVID-19 është rritur për çdo grup në studim, krahasuar me shifrat përkatëse para pandemisë.




Grafiku 25. Përqindja e PAK që e kanë pasur të vështirë ose shumë të vështirë aksesin ndaj medikamenteve para dhe gjatë pandemisë, sipas faktorëve të pavarur

Shkalla e vështirësisë për aksesin ndaj medikamenteve rezultoi e lidhur pozitivisht dhe në mënyrë domethënëse me praninë e problemeve financiare, si rezultat i drejtpërdrejtë i pandemisë, madje kjo lidhje forcohet më tej gjatë pandemisë: koeficienti i korrelacionit sipas Spearman midis këtyre dy treguesve është 0.207 para pandemisë dhe 0.273 pas pandemisë ($p<0.001$). Forcimi i lidhjes nënkupton rritjen e shkallës së vështirësisë për aksesin ndaj medikamenteve gjatë pandemisë.

1.4.6. Barrierat kryesore për të siguruar materialet mjekësore gjatë pandemisë

Pengesa kryesore për të siguruar materialet mjekësore që u nevojiteshin pjesëmarrësve me aftësi të kufizuar në studim gjatë kohës së pandemisë rezultoi "frika nga infektimi", e përmendur nga 55.3% e pjesëmarrësve, pasuar nga "pamundësia financiare për të përballuar trajtimin e sëmundjes dhe jetesën", e përmendur nga 51.4% e tyre, "kufizimi i lëvizjes së njerëzve dhe mjeteve" në 50.3% të rasteve dhe "mungesa e transportit publik" e përmendur në 31.7% të rasteve. Pengesa të tjera përfshinin pamundësinë fizike për të shkuar në farmaci (18.3%), largësinë e farmacisë nga banesa (15%), mungesa e medikamenteve apo produkteve të ndryshme (13.1%) dhe koha e kufizuar e qëndrimit hapur të farmacisë (8.9%) [Grafiku 26].
Mbi dy të tretat (67.5%) e PAK raportuan tri barriera kryesore për sigurimin e materialeve mjekësore që u nevojiteshin atyre gjatë pandemisë, 16.9% raportuan dy barriera, 8.3% një barrierë dhe 7.2% nuk raportuan ndonjë pengesë për këtë (Grafiku 26).



Grafiku 26. Barrierat kryesore për të siguruar materialet mjekësore gjatë pandemisë


Funded by UK Government

1.4.7. Konsultat me profesionistët e shëndetësisë gjatë pandemisë

Pjesëmarrësit me aftësi të kufizuar u pyetën nëse kanë marrë këshilla të veçanta nga profesionistët e kujdesit shëndetësor që kujdesen normalisht për gjendjen e tyre. Më shumë se gjysma (55.5%) e PAK që u përgjigjën raportuan se nuk kishin marrë këshilla të tilla nga profesionistët e kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë, kurse pjesa tjetër prej 45.5% raportuan se ishin këshilluar.


Midis PAK që kishin marrë këshilla mjekësore nga profesionistët e kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë, 85.1% e tyre raportuan se këshillat e dhëna ishin të vlefshme, sipas opinionit të tyre.

Nga ana tjetër, rreth 32.6% e PAK që dhanë informacion raportuan se nuk kanë pasur ndonjë konsultë në lidhjen me gjendjen e tyre shëndetësore gjatë pandemisë, 10.7% raportuan se kanë pasur konsulta të tilla ballë-për-ballë me stafin e kujdesit shëndetësor dhe 56.7% raportuan se kanë zhvilluar konsulta të tilla përmes telefonit ose internetit (Grafiku 27).




Grafiku 27. Zhvillimi i konsultave mjekësore gjatë pandemisë Covid-19

Nga ana tjetër, pjesëmarrësit me aftësi të kufizuar që kishin zhvilluar konsulta me stafin mjekësor u ftuan të vlerësonin dobishmërinë e këtyre konsultave (Grafiku 28).



Grafiku 28. Shkalla e dobisë së konsultave mjekësore gjatë pandemisë Covid-19 (vetëm midis PAK që kanë kryer konsulta të tilla)

Mund të vihet re që gjysma (49.8%) e PAK që kanë zhvilluar konsulta mjekësore për gjendjen e tyre gjatë pandemisë COVID-19 i vlerësojnë si mesatarisht të dobishme këto konsulta, 20.3% i vlerësojnë si jo të dobishme ose aspak të dobishme dhe 29.9% i vlerësojnë si të dobishme ose shumë të dobishme (Grafiku 28).
Grafiku 29 paraqet vlerësimin lidhur me dobishmërinë e konsultave mjekësore gjatë pandemisë COVID-19, sipas llojit të konsultimit: ballë për ballë apo përmes telefonit/ internetit.
Mund të vihet re që një përqindje shumë më e lartë e PAK e vlerësojnë konsultën ballë për ballë si të dobishme (54.3%), krahasuar me 3.2% e tyre që mendojnë të njëjtën gjë për konsultat përmes telefonit/internetit. Nga ana tjetër, vetëm 20% e PAK e konsiderojnë konsultën ballë-për-ballë si mesatarisht të dobishme, kundrejt 55.4% të tyre që mendojnë të njëjtën gjë për konsultat përmes telefonit/internetit. Së fundmi, vetëm 5.7% e PAK mendojnë se konsultat ballë-për-ballë janë jo të dobishme ose aspak të dobishme, kundrejt 23.1% që kanë të njëjtin mendim për konsultat përmes telefonit/internetit (Grafiku 29). Këto diferenca janë shumë domethënëse nga ana statistikore ($p<0.001$).




Grafiku 29. Shkalla e dobisë së konsultave mjekësore gjatë pandemisë, sipas llojit të konsultës

Ndërkohë, më shumë se një e treta (64.4%) e PAK deklaruan se pandemia COVID-19 e ka ndryshuar kalendarin e tyre të trajtimeve apo vizitave mjekësore. Grafiku 30 detajon mënyrat se si e ka ndryshuar pandemia COVID-19 kalendarin e trajtimeve apo vizitave mjekësore të PAK (për të cilët ka ndryshuar kalendari), duke paraqitur përqindjet përkatëse.


Funded by UK Government

Pandemia COVID-19 ka çuar në shtyrjen e ndërhyrjes së planifikuar në 54.3% të rasteve, në rreth 21% të rasteve realizimi i konsultave është realizuar përmes telefonit ose kompjuterit (online), në 15.9% të rasteve ka ndodhur ri-planifikim i vizitës apo konsultës, në 9.1% të rasteve vetë personat me aftësi të kufizuar apo kujdestarët e tyre e kanë anuluar vizitën apo konsultën e planifikuar dhe në 0.4% të rasteve kjo ka ndodhur nga mjeku (Grafiku 30).



Grafiku 30. Ndryshimi i kalendarit të trajtimeve apo vizitave mjekësore të PAK nga pandemia

Midis PAK për të cilët ndërhyrja e planifikuar u shty në kohë për shkak të pandemisë COVID-19, në mbi gjysmën e tyre (60.1%) ndërhyrja u shty për tre muaj ose më shumë, në 12.2% të rasteve ndërhyrja u shty për dy muaj, në 14.6% të rasteve u shty për një muaj dhe në 13% të rasteve u shty për 1 një javë (Grafiku 31).




Grafiku 31. Për sa kohë u shty ndërhyrja e planifikuar si pasojë e pandemisë COVID-19 (vetëm midis PAK për të cilët është shtyrë ndërhyrja)

Shtyrjet e ndërhyrjeve të planifikuara për PAK prej 3 muajsh ose më shumë ndodhën në mënyrë domethënëse më shpesh në qarkun e Tiranës (69.6%), Durrësit (60%) dhe Korçës (60%), krahasuar me përqindjet përkatëse në Shkodër (0%), Elbasan (57.2%) dhe Gjirokastër (48.4%), kurse diferencat sipas faktorëve të tjerë të pavarur nuk rezultuan statistikisht domethënëse.

1.4.8. Efektiviteti i kujdesit ambulator gjatë pandemisë Covid-19


Personat me aftësi të kufizuar të përfshirë në studim u ftuan të ndanin me ne opinionin e tyre lidhur me efektivitetin e kujdesit ambulator gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Më shumë se katër në dhjetë (43.7%) pjesëmarrës me aftësi të kufizuara mendojnë që kujdesi ambulator gjatë pandemisë ka qenë jo efektiv ose krejtësisht jo efektiv, 28.5% mendojnë se efektiviteti ka qenë mesatar, kurse 27.8% mendojnë se kujdesi ambulator gjatë pandemisë ka qenë efektiv ose shumë efektiv (Grafiku 32).



Grafiku 32. Opinioni i PAK lidhur me efektivitetin e kujdesit ambulator gjatë pandemisë

Funded by UK Government

Përqindja e PAK ose kujdestarëve të tyre që mendojnë se kujdesi ambulator gjatë pandemisë ka qenë krejtësisht jo efektiv ose jo efektiv është më i lartë midis pjesëmarrësve 5-10 vjeç (63.6%), midis meshkujve (51.9%), midis PAK që jetojnë në Elbasan (72.7%) dhe Tiranë (62.4%), dhe rritet me rritjen e numrit të paaftësive: 41.5% midis atyre me një paaftësi, 45.5% midis PAK me dy paaftësi, 61.9% midis PAK me tre paaftësi dhe 66.7% midis PAK me katër paaftësi (Grafiku 33).




Grafiku 33. Përqindja e PAK që mendon se kujdesi ambulator gjatë pandemisë ishte krejtësisht jo efektiv ose jo efektiv, sipas faktorëve të pavarur

1.4.9. Shqetësimet më të mëdha të PAK gjatë periudhës së pandemisë

Pjesëmarrësit u ftuan të na informonin lidhur me shqetësimet më të mëdha që ata kanë ndjerë ose përjetuar gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.

Shqetësimi madhor më i shpeshtë gjatë kohës së pandemisë, i raportuar nga 58.9% e pjesëmarrësve, rezultoi "pamundësia financiare për të blerë ilaçe ose produkte ushqimore", pasuar nga "frika nga infektimi me COVID-19" në 56.4% të pjesëmarrësve, "përkeqësimi i gjendjes shëndetësore" në 30.6% të rasteve, "mos marrja e ndihmës që nevojitet" në 29.2% të pjesëmarrësve, "kalimi në një formë të rëndë të COVID-it" në 23.1% të rasteve, "frika nga izolimi" në 21.4% të rasteve, "përkeqësimi i shëndetit mendor" në 20.6% të rasteve, etj. (Grafiku 34).

Vetëm 2.8% e pjesëmarrësve raportuan se nuk kishin asnjë shqetësim specifik gjatë periudhës së pandemisë, kurse mbi dy të tretat (69.4%) kishin 3 lloje shqetësimesh (Grafiku 34).




Grafiku 34. Shqetësimet madhore të PAK gjatë periudhës së pandemisë

Funded by UK Government

1.4.10. Udhëzimet specifike për njerëzit me aftësi të kufizuar gjatë pandemisë

Pjesëmarrësit u pyetën lidhur me udhëzimet specifike që ata mendojnë se u janë dhënë posaçërisht atyre gjatë pandemisë. Udhëzimi më i shpeshtë, i përmendur nga 62.2% e pjesëmarrësve ishte "qëndroni në shtëpi dhe mos dilni", pasuar nga "respektoni distancimin fizik" i përmendur në 21.9% të rasteve, kurse udhëzime të tjera, pa i specifikuar ato, u raportuan nga 3 subjekte ose 0.8% e të gjithë pjesëmarrësve. Në total 274 persona me aftësi të kufizuar ose 76.1% e të gjithë pjesëmarrësve në studim raportuan se kishin marrë udhëzime, sipas tyre specifike, për personat me aftësi të kufizuar për të përballuar pandeminë. Midis këtyre, 88% kanë marrë një lloj udhëzimi, 11.3% kanë marrë dy lloje udhëzimesh dhe 0.7% kanë marrë tre lloje udhëzimesh (këto të dhëna nuk paraqiten në Grafikë).

Midis pjesëmarrësve që kishin marrë udhëzime specifike për personat me aftësi të kufizuar gjatë periudhës së pandemisë, burimi kryesor i udhëzime ishte qeveria (në 78.5% të rasteve), pasuar nga ofruesit e kujdesit shëndetësor (në 15.7% të rasteve), Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar (në 13.9% të rasteve) dhe farmacisti në 3.6% të rasteve (Grafiku 35).




Grafiku 35. Burimet e udhëzimeve specifike për PAK gjatë periudhës së pandemisë

1.4.11. Nevojat për të menaxhuar më mirë njerëzit me aftësi të kufizuar gjatë pandemisë

Pjesëmarrësit u ftuan të jepnin opinion e tyre lidhur me disa mënyra për të menaxhuar më mirë gjendjen e tyre gjatë pandemisë, si dhe të jepnin mendimin e tyre të lirë rreth mënyrave të tjera që ata i mendojnë të rëndësishme.


Më shumë se tre të katërtat (78.3%) e pjesëmarrësve u shprehën se dhënia e informacioneve dhe udhëzimeve më të qarta për PAK do të ndihmonte në menaxhimin më të mirë të gjendjes së tyre gjatë pandemisë, 4.2% ishin pro rritjes së mbështetjes përmes platformave online (telefon, internet), 3.1% mendojnë se mbështetja financiare dhe logjistike do të ishte e duhura në këtë drejtim, 0.8% sugjeruan mbështetjen psikologjike dhe po kaq sugjeruan mbështetje më të madhe sociale dhe shëndetësore, ndërkohë që sugjerime të tjera përfshinin shërbimet në banesë (0.3%), mundësimin e ilaçeve (0.6%), lehtësimin e procedurave mjekësore dhe akses më i thjeshtë tek mjeku specialist (0.3%), më shumë kujdes për të vetmuarit (0.3%), etj. (Grafiku 36).



Grafiku 36. Ndërhyrjet për përmirësimin e menaxhimit të gjendjes së PAK gjatë pandemisë

1.4.12. Efektiviteti i përgjigjes së qeverisë në trajtimin e COVID-19 për PAK


Tre të katërtat (74.9%) e personave me aftësi të kufizuar që morën pjesë në studim dhe të cilët dhanë informacion mendojnë se përgjigja e qeverisë për trajtimin e COVID-19 për ta ka qenë krejtësisht joefektive (50.%) ose jo efektive (24.6%), 11.5% mendojnë se qeveria ishte mesatarisht efektive dhe pjesë tjetër mendojnë se ishte efektive (7.1%) ose shumë efektive (6.5%) [Grafiku 37].



Grafiku 37. Efektiviteti i përgjigjes së qeverisë në trajtimin e COVID-19 për PAK

Funded by UK Government


Grafiku 38 paraqet përqindjet e pjesëmarrësve që mendojnë se përgjigja e qeverisë ishte krejtësisht jo efektive ose jo efektive në trajtimin e COVID-19 për njerëzit me aftësi të kufizuar, sipas faktorëve të pavarur në studim.
Mund të vihet re që vlerat më të larta të këtij indikatori gjenden midis personave mbi 50 vjeç (82.4%), meshkujve (79.8%), ata që jetojnë në zonat rurale (75.9%), në Durrës (95%), Tiranë (82.3%) dhe Elbasan (82.1%), dhe tek personat me 4 lloje të ndryshme aftësish të kufizuara (100%).



Grafiku 38. Efektiviteti i përgjigjes së qeverisë në trajtimin e COVID-19 për PAK, sipas faktorëve të pavarur

Lidhur me masat që duhet të ishin marrë për të mbështetur personat me aftësi të kufizuar gjatë pandemisë COVID-19, informacioni i përftuar nga pjesëmarrësit paraqitet në Grafikun 39 në vijim.

Masa e përmendur më shpesh nga pjesëmarrësit (45.6% e tyre) ishte "ofrimi i bonusit/ mbështetjes financiare si rritje page, pensioni, kemp, ulje taksash, etj", pasuar nga "sigurimi i ushqimeve" në 10.6% të rasteve, "mbështetja shëndetësore" në 9.2% të rasteve, "sigurimi i ilaçeve" në 5.3% të rasteve, dhe "më shumë informacion dhe udhëzime të qarta" në 4.2% të rasteve, etj.




Grafiku 39. Masat që duhet të ishin marrë për të mbështetur PAK gjatë pandemisë COVID-19

Funded by UK Government

1.4.13. Vlerësimi i aftësive vetjake për të menaxhuar veten para dhe gjatë pandemisë


Pjesëmarrësit u ftuan të vlerësonin aftësitë e tyre vetjake për të menaxhuar veten e tyre para dhe gjatë pandemisë COVID-19. Vlerësimi i tyre paraqitet në Grafikun 40.
Për fat të keq, proporcioni i personave me aftësi të kufizuar (ose kujdestarëve të tyre) që mendojnë se aftësitë e tyre për të menaxhuar veten e tyre janë aspak efektive ose jo efektive rriten gjatë pandemisë, krahasuar me periudhën para pandemisë. Për shembull, përpara pandemisë 9.6% e personave me aftësi të kufizuar mendonin se aftësitë e tyre ishin aspak efektive për të menaxhuar veten e tyre para pandemisë, por gjatë pandemisë kjo shifër shkon në 30.1%; po kështu, para pandemisë 29.3% mendonin se aftësitë e tyre ishin jo efektive për të menaxhuar veten e tyre, kurse gjatë pandemisë ky proporcion shkon në 38.2%. Nga ana tjetër, gjatë pandemisë u ul shumë përqindja e personave me aftësi të kufizuar që mendojnë se mund ta menaxhojnë veten e tyre në mënyrë efektive ose shumë efektive: nga 24.3% para pandemisë në 5.4% gjatë pandemisë (Grafiku 40).



Grafiku 40. Vlerësimi i aftësive vetjake për të menaxhuar veten para dhe gjatë pandemisë


1.4.14. Aktiviteti fizik, pesha trupore dhe ankthi gjatë pandemisë

Pjesëmarrësit u pyetën lidhur me aktivitetin fizik dhe peshën trupore gjatë pandemisë. Dy të tretat (66.7%) e pjesëmarrësve raportuan se ishin më pak aktivë se zakonisht gjatë pandemisë, kurse më shumë se një e katërta (26.2%) raportuan se kishin shtuar peshën trupore (Grafiku 41).



Grafiku 41. Ndryshimi i aktivitetit fizik dhe peshës trupore gjatë pandemisë


Nga ana tjetër, pjesëmarrësve në studim iu kërkua të vlerësonin nivelin e ankthit të përjetuar gjatë pandemisë në një shkallë nga 1 (aspak ankth) në 5 (kam qenë shumë i/e shqetësuar). Më shumë se tre të katërtat (78%) e personave me aftësi të kufizuar kanë qenë shumë në ankth (50.4%) ose në ankth (27.6%) gjatë pandemisë, 14.5% kanë përjetuar ankth mesatar, kurse vetëm 7.4% nuk janë ndjerë në ankth (4.3%) ose nuk janë ndjerë aspak në ankth (3.1%) [Grafiku 42].



Grafiku 42. Niveli i ankthit të përjetuar gjatë pandemisë

Funded by UK Government


Në Grafikun 43 paraqiten përqindjet e personave me aftësi të kufizuar që kanë qenë shumë në ankth ose në ankth gjatë pandemisë, sipas faktorëve të pavarur të përfshirë në studim. Mund të vihet re që përqindjet e personave me aftësi të kufizuar që kanë përjetuar nivele të larta të ankthit gjatë pandemisë gjenden tek ata me moshë >60 vjeÇ (84.8%), tek femrat (81.3%), tek ata që jetojnë në zonat rurale (80%), në Durrës (92.7%), Tiranë (92.1%) dhe Korçë (89.4%), dhe rritet me numrin e paaftësive të pranishme (nga 66.7% tek ata me një paaftësi në 78.9% tek ata me katër lloje paaftësish).



Grafiku 43. Proporcionet e PAK që kanë përjetuar shumë ankth ose kanë përjetuar ankth (niveli 4) gjatë pandemisë, sipas faktorëve të pavarur

1.5.Testimi për COVID-19

Pjesëmarrësit u ftuan të na informonin lidhur me testimin e tyre për COVID-19. Midis 360 subjekteve të përfshirë në studim, vetëm 14 ose 3.9% e tyre deklaruan se ishin testuar.
Midis atyre që u testuan për COVID-19, 54.5% deklaruan se arsyeja e testimit ishte prania e simptomave të COVID-19, kurse 45.5% u testuan për shkak të kontakteve me dikë që kishte COVID-19.
Midis pjesëmarrësve të testuar për COVID-19, 85.7% e tyre rezultuan negativ dhe 14.3% rezultuan pozitiv në testim. Për 40% të personave të testuar dhe që dhanë informacion, vendimi për t'u testuar për COVID-19, në kontekstin kur kishin simptoma dhe/ose ishin në dijeni që kanë pasur kontakte me persona të prekur nga COVID-19, ishte i vështirë ose shumë i vështirë, në 50% të rasteve testimi ishte mesatarisht i vështirë dhe në 10% të rasteve vendimi për t'u testuar ishte i lehtë (Grafiku 44).



Grafiku 44. Të dhëna lidhur me testimin për COVID-19 midis pjesëmarrësve në studim

Asnjë nga personat e testuar nuk pranoi të shtrohej në spital për të trajtuar infeksionin COVID-19.

Funded by UK Government

1.



KONKLUZIONE

Bazuar në rezultatet e parashtruara më sipër, konkluzionet e këtij studimi janë si vijon:

1.1. Situata e përgjithshme e personave me aftësi të kufizuara

- Më shumë se gjysma e personave me aftësi të kufizuar (PAK) përjetojnë shumë vështirësi për të kryer detyrat e përditshme.

1.2. Gjendja ekonomike e PAK gjatë periudhës së pandemisë COVID-19

- Midis PAK në moshë pune, rreth një e pesta e tyre janë të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme. Kjo është një përqindje mjaft e ulët në kontekstin kur institucionet publike dhe sipërmarrjet private e kanë detyrim ligjor punësimin e PAK.
- Gjysma e PAK të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme janë të pasiguruar; kjo shton më tej pasigurinë e tyre për të ardhmen, pasi i vendos në pozicion akoma më të disavantazhuar.
- Pandemia COVID-19 duket se goditi veçanërisht rëndë PAK në marrëdhënie pune, pasi rreth një e pesta e tyre e humbi punën që kishte, kurse dy të pestat e tyre u pezulluan përkohësisht.
- Efektet negative të pandemisë COVID-19 në punësimin e PAK në përgjithësi prekën të gjitha grupet në studim: mbi 60% e femrave dhe meshkujve, PAK të moshës 41-60 vjeç, me banim në zonat urbane dhe rurale, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Korçë, si dhe PAK me një apo dy lloje paaftësish, të cilët ishin në marrëdhënie pune para pandemisë, u pezulluan nga puna apo humbën punën gjatë pandemisë.
- Ruajtja e vendit të punës nuk është garanci për ruajtjen e nivelit të të ardhurave për PAK në marrëdhënie pune, pasi, për rreth 30% të tyre u ulën të ardhurat gjatë pandemisë si pasojë e reduktimit të pagës. Në total, pandemia Covid-19 uli të ardhurat për 72.5% të PAK të punësuar.
- Përtej punësimit, më shumë se 8 në 10 PAK kanë pasur probleme financiare të drejtpërdrejta si rezultat i pandemisë COVID-19. Grupet më të prekura janë: meshkujt, PAK në moshë të madhe, në zonat rurale, Durrës e Shkodër, dhe ata me katër lloje aftësisht të kufizuara.
- Ulja e të ardhurave, pamundësia për të përballuar jetesën, humbja e vendit të punës, dhe nevojat e rritura për ushqime, ilaçe dhe detergjente përbënin mbi 95% të të gjitha efekteve të drejtpërdrejta të pandemisë COVID-19 tek PAK që pohuan se u prekën financiarisht nga kjo pandemi.
- Këtyre vështirësive i shtohet dhe fakti që më shumë se 9 në 10 PAK deklaruan se nuk kanë përfituar asgjë nga paketat financiare të qeverisë.
- Në këto kushte, mbështetja financiare e PAK ka ardhur nga organizata apo fondacione të ndryshme (në 41% të rasteve), institucionet publike (në 25% të rasteve), dhe nga familjarët apo të afërmit në 21% të rasteve.
- Duke kombinuar ndihmat nga qeveria dhe burimet e tjera, rezulton se më shumë së 1 në 5 PAK nuk kanë marrë mbështetje nga asnjë burim gjatë pandemisë COVID-19. Më të rrezikuar për të mos marrë asnjë mbështetje janë PAK >60 vjeç, ata që jetojnë në zonat urbane, Durrës, Elbasan dhe Korçë, dhe ata me disa lloje aftësisht të kufizuara.
- Rreth 9 në 10 PAK kanë përjetuar vonesa të pagesës së paaftësisë gjatë pandemisë, kryesisht për shkak të akordimit me vonesë të fondeve nga buxheti i shtetit, izolimit, pamundësisë fizike për t'i tërhequr, etj.

1.3. Gjendja shëndetësore e PAK dhe trajtimi i tyre gjatë pandemisë COVID-19

- Situata dhe kufizimet gjatë pandemisë COVID-19 çuan në uljen drastike të përqindjes së PAK që trajtoheshin në qendrat rezidenciale, ditore dhe komunitare, dhe rritjen e përqindjes së PAK që u trajtuan në shtëpitë e tyre, krahasuar me periudhën para pandemisë, si dhe në ndërprerjen e trajtimit në 15% të rasteve. Të gjitha këto ndryshime mund të kenë çuar në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të PAK për shkak të shërbimeve të munguara.
- Kjo mund të mbështetet nga fakti se gjendja shëndetësore u përkeqësua gjatë pandemisë për rreth 4 në 10 PAK, duke reflektuar ndoshta një zhvendosje të shërbimeve dhe trajtimit nga qendrat e specializuara në shtëpi. Shëndeti u përkeqësua në përqindje më të larta tek PAK 11-18 vjeç dhe 51-60 vjeç, në zonat rurale, Durrës e Korçë, dhe ata me 2-3 lloje aftësisht të kufizuara.
- Ndihma shëndetësore gjatë pandemisë është kërkuar nga mbi gjysma e PAK, dhe midis këtyre ndihma nga mjeku i familjes është kërkuar në rreth dy të tretat e rasteve, duke nënkuptuar që mjeku i familjes ka qenë burimi kryesor i ndihmës shëndetësore për PAK gjatë pandemisë.
- Rreth një në katër PAK kanë kontaktuar më pak se zakonisht me mjekun e familjes gjatë pandemisë.
- Rreth 17% e PAK mendojnë se shërbimi shëndetësor u përkeqësua gjatë pandemisë, krahasuar me periudhën para pandemisë, dhe kjo përqindje është më e lartë tek 11-18 vjecarët dhe PAK >60 vjeç, meshkujt, PAK që jetojnë në zonat rurale, Shkodër, Korçë dhe Elbasan, dhe rritet me rritjen e numrit të aftësive të kufizuara duke arritur në 100% midis PAK me katër aftësi të kufizuara.
- Gjatë pandemisë u rrit në mënyrë domethënëse përqindja e PAK që patën vështirësi në aksesin ndaj medikamenteve, krahasuar me periudhën para pandemisë (70.4% gjatë pandemisë vs. 38.1% para pandemisë), dhe kjo tendencë ishte e pranishme në çdo grup të PAK në studim. Kjo gjetje sugjeron që të gjithë PAK janë vënë nën presion të konsiderueshëm gjatë pandemisë për sigurimin e medikamenteve të nevojshme për ta.
- Mesa duket, fushata agresive e informimit dhe mesazhet e dhëna për pandeminë, kufizimi i transportit publik dhe mungesa e koordinuar e mbështetjes financiare kanë krijuar pengesa për sigurimin e materialeve mjekësore të nevojshme gjatë pandemisë për shumicën dërrmuese të PAK (më shumë se 9 në 10 PAK raportuan të paktën një pengesë për të siguruar materialet mjekësore gjatë pandemisë).
- Mënyra kryesore e konsultimeve mjekësore të PAK gjatë pandemisë ishte ajo përmes telefonit ose internetit (në 57% të rasteve) dhe ballë për ballë në 11% të rasteve, kurse rreth 33% nuk morën fare konsultime mjekësore; dobishmëria e konsultave ballë për ballë u pranua nga përqindje në mënyrë domethënëse më të larta të PAK, krahasuar me konsultat në distancë.
- Efekti kryesor i pandemisë në ndërhyrjet e planifikuara tek PAK rezultoi shtyrja apo ri-planifikimi i ndërhyrjes (në rreth 70% të rasteve), kalimi në konsultën në distancë (21%), apo anulimi i konsultës në rreth 10% të rasteve. Në 6 në 10 raste kur u shty ndërhyrja, ajo u shty për 3 muaj ose më shumë, me diferenca domethënëse sipas qarqeve.
- Kujdesi ambulator gjatë pandemisë është perceptuar si krejtësisht jo efektiv apo jo efektiv për më shumë se 4 në 10 PAK: përqindjet më të larta janë midis PAK 5-10 vjeç,

meshkujve, ata që jetojnë në Elbasan dhe në Tiranë, dhe rritet me rritjen e numrit të aftësive të kufizuara.

- Pothuajse të gjithë PAK kanë përjetuar të paktën një shqetësim specifik gjatë pandemisë, ku shqetësimi më i shpeshtë ishte "pamundësia financiare për të blerë ilaçe dhe ushqime", "frika nga infektimi", "shqetësimi për përkeqësimin e gjendjes shëndetësore vetjake" dhe "frika e mos marrjes së ndihmës së nevojshme".
- Më shumë se 7 në 10 PAK kanë përjetuar nivele të larta ankthi (mbi mesataren) gjatë pandemisë, dhe kjo përqindje rezultoi më e lartë midis PAK >60 vjeç, tek femrat, ata që jetojnë në zonat rurale, Durrës, Tiranë, Korçë, dhe rritet me rritjen e numrit të aftësive të kufizuara.
- Mbi tre të katërtat e PAK raportuan se kanë marrë udhëzime specifike gjatë pandemisë, ku mesazhi dominues ishte "mos dilni nga shtëpia", pasuar nga "respektoni distancimin fizik". Burimi kryesor i udhëzimeve ishte qeveria (në 79% të rasteve), kurse roli i ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuar ka qenë i vogël në këtë drejtim (16% dhe 14%, përkatësisht).
- Rreth 8 në 10 PAK sugjeruan se thjesht "dhënia e informacioneve dhe udhëzimeve më të qarta për PAK" do të ndihmonte në menaxhimin më të mirë të gjendjes së tyre gjatë pandemisë.
- Më shumë se 7 në 10 PAK mendojnë se përgjigja e qeverisë për trajtimin e pandemisë për ta ka qenë krejtësisht joefektive ose jo efektive, më përqindje më të larta të këtij indikatori midis PAK >50 vjeç, meshkujve, PAK që jetojnë në zonat rurale, Durrës, Tiranë dhe Elbasan, dhe ata me 4 lloje aftësish të kufizuara.
- Rreth gjysma e PAK sugjeruan se mbështetja financiare do ishte mbështetja e duhur për ta gjatë pandemisë, pasuar nga sigurimi i ushqimeve, mbështetja shëndetësore dhe sigurimi i ilaçeve.
- Gjatë pandemisë u rrit në mënyrë të konsiderueshme përqindja e PAK që mendojnë se aftësitë e tyre vetjake janë aspak ose jo efektive për të menaxhuar veten e tyre, krahasuar me periudhën para pandemisë. Kjo nënkupton një ulje të theksuar të besimit të PAK në aftësitë e tyre.
- Pandemia ndikoi në uljen e aktivitetit fizik për dy të tretat e PAK dhe shtimin e peshës trupore në një të katërtën e tyre.
- Vetëm 3.9% e PAK u testuan për COVID-19 dhe vetëm 2 individë, ose 14.3% e atyre që u testuan, rezultuan pozitivë, duke reflektuar ndoshta respektimin e përshtatshëm të masave dhe udhëzimeve për distancimin fizik dhe qëndrimin të izoluar në shtëpitë e tyre.



REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet dhe konkluzionet e këtij studimi, rekomandimet tona janë si vijon:

- Duhet të zbatohet me rigorozitet ligji në fuqi për respektimin e kuotave të punësimit të PAK në institucionet publike dhe private dhe mbulimin e tyre me siguracione.
- Të gjithë personave me aftësi të kufizuar duhet t'u sigurohet mbështetja e përshtatshme financiare gjatë pandemisë, me vëmendje të veçantë tek grupet më të rrezikuara ndër ta, duke i krijuar kështu mundësinë atyre të përballojnë jetesën, dhe nevojat e shtuara ushqimore dhe mjekësore gjatë kësaj periudhe të vështirë.
- Duhet të inkurajohet dhe të rritet roli i organizatave, fondacioneve dhe grupimeve të tjera të cilët mund të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për PAK në periudhën e pandemisë. Po kështu, strukturat e qeverisjes lokale duhet të jenë më aktive dhe të pranishme në mbështetje të PAK, duke organizuar ndihma/paketa të dedikuara që i përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuar.
- Paketat financiare të qeverisë duhet të përfshijnë medoemos dhe PAK pavarësisht statusit të punësimit të tyre, sepse PAK përbën një ndër grupet më të pambrojtur të shoqërisë dhe në rrezik shumë të lartë për përkeqësimin e shpejtë të situatës së tyre financiare, shëndetësore dhe sociale në kushtet e pandemisë.
- Duhet të merren të gjitha masat që të shmangen vonesat e pagesës së paaftësisë gjatë pandemisë, pasi ky fenomen preku pothuajse të gjithë personat me aftësi të kufizuara, duke vështirësuar edhe më tej gjendjen e tyre. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar ndaj PAK.
- Është e nevojshme të planifikohet paraprakisht mënyra e vazhdimit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për PAK dhe të shmanget mungesa e shërbimeve specifike për ta në periudhat e pandemisë, si një masë efektive për të ruajtur gjendjen shëndetësore të tyre dhe mos-ndërprerjen e trajtimit.
- Në rastet kur situata kërkon që trajtimi i PAK të realizohet në kushtet e shtëpisë, atëherë duhet të jenë në dispozicion protokollet, udhëzimet përkatëse, si dhe një sistem efektiv i informimit të PAK dhe konsultave mjekësore lidhur me procedurat që tashmë duhet të kryhen në shtëpi nga vetë ata. Natyrisht, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet grupeve më të rrezikuara për shëndet të dobët midis personave me aftësi të kufizuar, ku veçohen personat me një numër të madh aftësish të kufizuar (3-4 lloje paaftësish) dhe ata mbi 60 vjeç.
- Është thelbësore të trajnohen mjekët e familjes lidhur me trajtimin e PAK, nevojat e tyre specifike dhe të shtuara në sfondin e pandemisë dhe ka nevojë të forcohen aftësitë trajtuese në distancë të mjekëve, duke qenë se mjeku i familjes rezulton burimi kryesor i kujdesit shëndetësor për PAK gjatë pandemisë.
- Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e PAK mendojnë se konsultimet online nuk janë shumë të dobishme, është e nevojshme që të gjenden mënyrat për ta bërë këtë proces më efektiv për personat me aftësi të kufizuar, siç e përmendëm më sipër. Kjo mund të përfshijë seanca të mirëfillta trajnimi të personelit shëndetësor lidhur me aspekte të ndryshme të këtij procesi, identifikimin e platformave të përshtatshme të konsultave në distancë, por edhe edukimin e PAK lidhur me konsultat në distancë. Këto do rrisnin edhe besimin e PAK tek aftësitë vetjake për të menaxhuar veten e tyre gjatë pandemisë.
- Duhet të bëhen përpjekje për të kuptuar arsyet se përse një pjesë e mirë e PAK e konsiderojnë jo efektiv kujdesin ambulator gjatë pandemisë, në mënyrë që të merren masat për përmirësimin e këtij kujdesi me qëllim ofrimin e shërbimeve ambulatore cilësore për këtë grup të popullatës.

- Duhet të tregohet një kujdes shumë i madh në mënyrën se si përçohen mesazhet dhe udhëzimet gjatë pandemisë, pasi dhënia e tyre në mënyrë agresive dhe të pa-diferencuar mund të krijojë perceptime të gabuara në grupe të ndryshme të popullatës ose frikësim të tepruar të tyre, përfshirë edhe PAK, duke u kthyer kështu në pengesa të panevojshme për sigurimin e materialeve mjekësore në këtë periudhë.
- Në këtë logjikë, përshtatja e mesazheve gjatë kohës së pandemisë sipas nevojave dhe situatës së grupeve të caktuara të popullsisë, përfshirë dhe PAK, do të ndikonte në uljen e ankthit dhe shqetësimit të tyre lidhur me situatën dhe krijimin e shpresës për përmirësimin e saj. Natyrisht, kjo mund të funksionojë vetëm përmes një bashkërendimi të mirë të të gjithë strukturave të shtetit dhe të shoqërisë, marrjes së masave të përshtatshme dhe ofrimin e mbështetjes efektive për të gjitha grupet e popullatës më në nevojë. Institucionet që mund të angazhohen në përmbushjen e këtij rekomandimi janë: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik dhe organizatat e shoqërisë civile që kanë në objekt të punës së tyre edukimin shëndetësor të popullatës.
- Ne rekomandojmë që duhet të ofrohet shumë më tepër për PAK lidhur me informimin dhe udhëzimin e tyre se si të menaxhojnë veten e tyre gjatë pandemisë sesa vetëm mesazhet xhenerike, të tipit "mos dilni nga shtëpia" dhe "respektoni distancën fizike", të cilat janë thjesht të pamjaftueshme, jo efektive dhe jo specifike për PAK në këtë drejtim. Këto mesazhe funksionojnë vetëm nëse është krijuar një infrastrukturë e përshtatshme për përçimin efektiv të këshillave mjekësore dhe nëse ofrohet mbështetja e duhur financiare dhe sociale. Institucionet që mund të angazhohen në përmbushjen e këtij rekomandimi janë: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik, përmes bashkëpunimit me televizionet kombëtare.
- Ne mendojmë se duhet të jepen udhëzimet e duhura dhe në një gjuhë të kuptueshme për PAK edhe për një arsye tjetër: për të rritur besimin e tyre në aftësitë vetjake për të menaxhuar veten e tyre gjatë pandemisë, indikator ky që u përkeqësua shumë gjatë kësaj periudhe. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në të gjitha daljet e veçanta për masat që merren në vazhdim dhe komunikimet e përditshme për rastet e reja të të infektuarave me COVID-19 duhet t'i përshtatë në një gjuhë të kuptueshme edhe për personat me aftësi të kufizuar.
- Në rast se strukturat e qeverisë nuk mund të përçojnë me efektivitet udhëzimet e duhura për PAK në kohë pandemie, ne mendojmë se duhet të fuqizohet aftësia e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara në mënyrë që ajo të mund të luajë një rol të tillë përmes strukturave të saj ekzistuese ose ngritjes së kapaciteteve.
- Së fundmi, është e nevojshme të hetohen më në thellësi diferencat gjeografike (midis qarqeve) dhe socio-demografike lidhur me indikatorë të shumtë të gjendjes shëndetësore, financiare dhe trajtimit mjekësor të PAK gjatë pandemisë dhe të gjenden shkaqet e këtyre diferencave, në mënyrë që të adresohen ato në mënyrë të përshtatshme në funksion të lehtësimit të situatës së kësaj popullate.

Western Balkans Democracy Initiative



Westminster Foundation for Democracy (WFD)

www.wfd.org/wbdi